

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“Gjeo-Matias” sh.p.k

Tiranë më datë 27/08/2021.

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Gjeo-Matias” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **Gjeo-Matias”** sh.p.k

NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do te ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

Projekte topografike e konstruktive, rruge , kanalizimie. Rilevime topografike, plane rilevimi, planimetri, ekspertiza teknike-topografike, gen plane, matje tokash, ndarje dhe bashkim pasurie.

Sherbim i llogaritjes se volumeve, plan vendosje dhe piketime objektesh.Punime topo-geodezike. Matje faktike dhe perpunime te hartave.

Vlerësim i pasurive të paluajtshme për individë, shoqëri, banka, institucione shtetërore... Akte ekspertize. Konsulta hipotekore, ekspert gjykate.Projekte elektrike, civile e industriale. Projekte hidro-kondicionimi.

Ofrimi i shërbimeve të ndryshme të administrimit dhe mirëmbajtjes së ambjenteve të ndryshme, komplekse pallatesh, rezidenca, apartamente, hapsirave të përbashkëta të pallateve, qendra tregëtare, biznese të ndërthurura në komplekse banimi, insitucione shtetërore etj. Importimi dhe shitblerja me shumicë dhe pakicë e produkteve dhe pajisjeve në funksion të tyre. Ofrimi i shërbimeve te montimit në fushën e instalimeve elektrike, hidraulike, audio, instalimeve elektronike dhe informatike, ndërtimore dhe riparimeve të ndryshme me bojë, fasada, shërbime pastrimi, punime gipsi, mobilerie etj. Ushtrimi i veprimtarisë në fushën e administrimit të ndërtesave dhe të bashkëpronësisë së ndërtesave të banimit, të truallit dhe mjediseve ndihmëse që janë në bashkëpronsi të detyrueshme. Shitje e kamerave monitorimit, pajisjeve elektrike, sistemeve të alarmit, mjeteve kancelarike dhe parimi. Tregti me pakice dhe shumice e materialeve elektrike, hidro teknike, kondicionimit, inerte e cdo materiali ndertimi te nevojshem.Sherbime ligjore, konsulence ligjore dhe juridike, ekonomike.

Mirëmbajtje e dekorit, pastrimi i zonave urbane, ndricimin, sinjalizim, pastrim i ujërave te zeza, sipermarrje, punime duro-alumini etj.

Importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshem, industrial dhe bujqesor, si mallra dhe produkte ushqimore, konfeksione, materiale ndertimi, produkte farmaceutike, bime medicinale, makineri e paisje etj. Sherbime hotelerie, agjensi turistike, agjensi spedicioni, servis automjetesh, autoshkolla etj. Makina me qera. Sherbim dekori dhe eventesh.

Transport kombetar e nderkombetar te mallrave dhe udhetareve per vete e te trete.

Kryerjen e çdo operacioni ekonomik e juridik, shërbimesh, prodhues dhe tregtar e financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, për të cilin, në bazë të legjisllacionit shqiptar, kërkohet leje e posaçme nga organet kompetente të administratës publike.

NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirana Business Park, Ndertes 7, rruga e Rinasit, Tirane.

NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 40,000 (dyzete mijë) lekë. Kapitali ndahet në 2 (një) pjesë dhe pronësia e kuotës i përket ortakut:

z. Arbër Troka, i biri i Syrri, lindur në Fier, banues ne Rr. "Bulevardi Kasharit" Pall.Fratari, G.2, H.3, Ap.16, Astir, Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034764468 dhe nr. Personal I80822074B, i cili zotëron 50% të kuotave, i barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej 20,000 (njezete mijë) lekë.

z. Marjon Gorica, i biri i Ramadan-it, lindur në Tiranë më 01.02.1995, banues ne Rr. "Nezir Gorica", Unaza e Re, Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.032043718, dhe nr. Personal J50201069B, i cili zotëron 50% të kuotave, i barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej 20,000 (njezete mijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortaku Themelues.

NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7 - ORGANET DREJTUESE

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është **z. Arbër Troka**, i biri i Syrri, lindur në Fier, banues në Rr. "Bulevardi Kasharit" Pall.Fratari, G.2, H.3, Ap.16, Astir, Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034764468 dhe nr. Personal I80822074B, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5(pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8


Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.



NENI 11


Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES**ARBER TROKA****MARJON GORICA**